

UDHËZIM
Nr. 16, datë 22.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 27.2.2014, "PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 5.2.2014, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit", të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit nr. 15, datë 9.1.2015 dhe vendimit nr. 16, datë 26.2.2015 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 2 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“Procedurat e detajuara në këtë udhëzim do të ndiqen edhe në rastet:

a) e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të formës së prerë që i përkasin periudhës përpara datës 31.12.2013, por që janë dorëzuar pranë njësive të qeverisjes qendrore nga subjektet / individët / shërbimi përmbarimor përfitues gjatë viteve 2014-2015.

b) e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 dhjetor 2013.”.

2. Pas pikës 3 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"Nëse njësitë mund të shlyejnë një pjesë të detyrimeve të prapambetura me fondet e planifikuara për vitin 2015, mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit. Këto pagesa do të kryhen vetëm pas miratimit nga nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.”.

3. Në pikën 28 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", në fund të paragrafit shtohet fjalia "Njoftimi zyrtar dërgohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda 15 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të shkresës nga Ministria e Financave.”.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani